

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË PODUJEVË - Departamenti i përgjithshëm – divizioni civil:** me gjyqtarin Bujar Muzaqi, dhe sekretaren juridike Xhevide Selmani, në çështjen juridiko civile të Paditësit M.A.K. nga Fshati L., Komuna e P., të cilin e përfaqëson sipas autorizimit H. G. avokat nga P., kundër të Paditurës Kompania e Sigurimeve “I.” me seli në P., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Z.B. D. nga P., në çështjen kontestimore kompensim dëmi, pas mbajtjes së seancës kryesore, në prani të përfaqësuesve të autorizuar të paditësit, dhe të paditurës me datë 05.05.2014 morri këtë:

## **A K T G J Y K I M**

- I. PJESËRISHT APROVOHET** kërkesëpadia e Paditësit M.A.K. nga Fshati L., Komuna e P., **SI E BAZUAR.**  
**DETYROHET** e Paditura Kompania e Sigurimeve “I.” me seli në Prishtinë, t’ia paguan Paditësit M.K. për aksidentin e dt.02.03.2009 si pasojë e dëmit të pësuar në automjet dhe atë në emër të kompensimit të dëmit material për automjetin e aksidentuar shumë prej 4.300,00 Euro e të gjitha këto me kamatë vjetore siç e paguajnë Bankat afariste në Republikën e Kosovës kursimtarëve të vet në mjetet e deponuara mbi një vit pa destinim të caktuar duke filluar nga data e nxjerrjes së ekspertizës dt.13.01.2014 e të gjitha në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.
- II.** Përtej shumës së gjykuar shuma në lartësi prej 500,00 Euro për paditësin M. K., për bartjen e pjesëve nga Gjermania **REFUZOHET SI E PABAZUAR;**
- III. DETYROHET** e Paditura Kompania e Sigurimeve “I.” me seli në Prishtinë që paditësit t’ia kompensoi në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore shumë prej 683,00 Euro, të gjitha në afatin prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

## Ar sy e t i m

Paditësi në padi, dhe përmes përfaqësuesit të autorizuar ndër të tjera ka deklaruar se me datën 02.03.2009, në Podujevë, pikërisht në rrugën magjistrale Prishtinë-Podujevë, nga aksident trafiku Paditësi M.K. ka pësuar si pasojë e aksidentit dëm të konsiderueshëm material në automjetin e tij Kombi-Mercedes, po ashtu ka deklaruar se automjeti me të cilin është shkaktuar aksidenti ka qenë i siguruar te e Paditura.

Në seancën e shqyrtimit kryesor me datë 05.05.2014 Përfaqësuesi i autorizuar i Paditësit, avokat H. G. ndër të tjera deklaroi se ngeli në tërësi pranësi pranë kërkesëpadisë me prova materiale është vërtetua e njëjta nuk është kontestuese asgjë në këtë çështje për veç lartësisë së dëmit të shkaktuar konsideroi se vlera prej 3800 € sa është përcaktua në bazë të mendimit të ekspertit duhet ti shtohet plus edhe 1000 € për shkak të lyerjes së veturës dhe bartjes së pjesëve nga Gjermania.

E paditura në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 05.05.2014 nëpërmes përfaqësuesit të autorizuar të saj Z.B. D. ndër të tjera ka deklaruar se Mbesim pranë përgjigjes në padi si dhe në seancat e kaluara dhe në këtë seancë sa i përket precizimit të kërkesëpadisë të njëjten e kundërshtojmë për kah lartësia duke theksuar se baza juridike nuk është kontestuese dhe me qëllim të gjetjes së ndonjë zgjidhje në procedurë gjyqësore e paditura ka bërë vlerësimin e dëmit të shkaktuar në automjetin e paditësit dhe bazuar në censorin e kompanisë del se dëmi i shkaktuar në automjet është 2600 €uro dhe njëherit kjo është oferta të cilën e paraqet e paditura.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 05.05.2014 u administruan provat më të rëndësishme për vërtetimin e plotë dhe të drejt të gjendjes faktike siç janë : raporti i aksidentit i përpiluar nga Policia e Kosovës me nr. të rastit 09-AR-00469, dt. 02.03.2009, Aktvendimi i Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Podujevë me nr. të regjistrimit 1221/09-1 i dt.19.03.2009, ekspertiza e dëmit e përpiluar më dt.17.03.2009 te e paditura Kompania e Sigurimeve "I." si dhe provat tjera në shkresat e lëndës.

Pas vlerësimit me kujdes dhe me ndërgjegje të secilës provë veç e veç dhe të gjithave bashkërisht e në pajtim me dispozitat e nenit 8 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, kjo Gjykatë lidhur me këtë çështje kontestimore juridiko – civile vërtetoi se :

- Në bazë të Raportit të Aksidentit të Shërbimit Policor të Kosovës me nr. të rastit 09-AR-00469 të dt. 02.03.2009 u vërtetua se me dt.02.03.2009 ka ndodhur aksidenti trafiku;

Në rastin konkret Gjykata mendimit të ekspertit ia dha besimin e plotë dhe e miratoj ne tërësi ekspertizën e kryer e cila ka elemente të mjaftueshme dhe të dhëna mbi bazën e njohurive profesionale për vërtetimin e kësaj çështje kontestimore dhe atë ,

-Mendimit të dhënë me shkrim me dt.13.01.2014 nga eksperti i makinerisë Prof.Dr.F. K. ndër të tjera ka deklaruar se “ **...M. A. K...për riparimin e kombit të aksidentuar Mercedes – 616D me targa të regjistrimit numër i targave... duhet ti paguhet shuma prej 3800 €...**”, i cili mendimin e tij e ka plotësuar edhe në procesverbalin e seancës së dt.05.05.2014 ku ndër të tjera ka deklaruar se “**... për ngjyrosjen e kësaj veture ku është dëmtuar jan nevojitur 500 €...**”.

Në lidhje me bazën juridike, e paditura në përgjigjen në padi të dt.03.02.2014 si dhe në seancën e shqyrtimit kryesor nëpërmes përfaqësuesit të autorizuar të saj ka deklaruar se nuk e kundërshtojmë bazën juridike.

Kontestuese mbetet lartësia e dëmit e precizuar nga i autorizuari i paditësit me dt.05.05.2014.

Lidhur me lartësinë e aprovuar për kompensimin e dëmit material të shkaktuar në automjetin e aksidentuar Kombi Mercedes për Paditësin M. A. K. të përmendur sikurse në dispozitiv të këtij Aktgjykimi është aprovuar bazuar në nenin 185,186 dhe dispozitave tjera të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore, ndërsa për shumën e kompensimit të dëmit në automjet është bazuar në nendimin e dhënë nga eksperti për vlerësimin e dëmit material në automjetin Prof. Dr. F. K. i cili në mendimin e dhënë ndër të tjera ka deklaruar se “ **...M. A. K...për riparimin e kombit të aksidentuar Mercedes – 616D me targa të regjistrimit numër i targave... duhet ti paguhet shuma prej 3800 €...**”, i cili mendimin e tij e ka plotësuar edhe në procesverbalin e seancës së dt.05.05.2014 ku ndër të tjera ka deklaruar se “**... për ngjyrosjen e kësaj veture ku është dëmtuar jan nevojitur 500 €...**”. po ashtu me rastin e caktimit të lartësisë së dëmit kjo gjykatë pati në konsiderim të gjitha rrethanat që ndikojnë në përcaktimin e tij, dhe shuma e caktuar do të jetë ekuivalente me dëmin e pësuar duke i refuzuar për tej pjesës së gjykuar shumën që në fjalën përfundimtare e ka paraqitur përfaqësuesi i autorizuar i Paditësit duke u bazuar në atë që shuma e aprovuar të mos i shkojë përshtati synimeve të njëjës palë për fitim pa bazë dhe kundër interesit të përgjithshëm shoqëror.

Gjykata paditësit për veç kërkesës kryesore ja njohu, edhe kërkesën me kamatë vjetore të cilën e paguajnë Bankat afariste në Republikën e Kosovës për mjete të deponuara për një vit pa destinim të caktuar për të gjitha format e dëmit nga dita kur është mbajtur gjykimi, për kamatë Gjykata zbatoi dispozitat e neneve 277, 278 të LMD-së, duke vendosur si në dispozitiv.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore Gjykata u bazua në nenin 452.2 par.2 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore dhe Tarifës së Odes së Avokatëve duke e obliguar të paditurën që paditësit t’ia paguaj vetëm pjesën proporcionale dhe të domosdoshme të shpenzimeve procedurale për zhvillimin e procesit gjyqësor dhe atë shpenzimet për padi shumën prej 78 Euro, për përfaqësime në 3 seanca gjyqësore shumën nga 405 Euro, për ekspertizen mbi vlerësimin e dëmit material në automjet shumën prej 150 Euro, si dhe taksën gjyqësore për padi dhe për

aktgjykim në shumë prej 50 €uro.

Prandaj, nisur nga të lartcekurat dhe duke ju referuar nenit/eve 185, 200, 201 dhe dispozitave tjera të Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve dhe konform nenit/eve 4, 5, 7, 8 10, 321, 323 147.1, 452 dhe dispozitave tjera të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, dhe konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ nr.2008/02 për unifikimin e taksave gjyqësore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**DEGA NË PODUJEVË**  
**C.nr.615/2009 datë 05.05.2014**

**Gjyqtari,**  
**Bujar Muzaqi**

**KËSHILLA JURIDIKE** : Kundër këtij Aktgjykimi lejohet ankesa në afatin prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj Gjykate.